

Në bazë të nenit 5 të rregullorës së punës së Këshillit Drejtues thërras mbledhjen e tetë me radhë të Këshillit Drejtues të Akademisë dhe propozoj këtë:

REND DITE

1. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e gjashtë;
2. Miratimi i plotësimit të rregullores mbi përcaktimin e tarifave në studime dhe shërbime në Akademinë Tempulli
3. Marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve të rinjë
4. Caktimi i tarifave të studimeve në Akademinë Tempulli
5. Të tjera.

Mbledhja do të mbahet në Akademi në sallën e takimeve më 07.06.2023 (e mërkurë) në ora 10:00.

Kryetare e Këshillit Drejtues

Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi



E K S T R A K T

Nga mbledhja e tetë e Këshillit Drejtues të mbajtur me datë 07.06.2023, në Akademi duke filluar prej orës 10.00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi –Kryetare e e Këshillit Drejtues.
2. MSc.Sara Fusha Osmani - Zëvendës Kryetare e Këshillit Drejtues
3. MSc. Lutfi Gashi – anëtar nga shoqëria civile
4. MSc. Sami Mazreku – anëtar Këshilli i Partënerëve
5. Arsim Zagragja-anëtar nga Parlamenti Studentor i Akademisë
6. Dr.Sc.Muhamed Krasniqi Drjtor i Akademisë – anëtar pa të drejtë vote;
7. Fatime Krasniqi Sekretare e Përgjithshme e Akademisë - anëtar pa të drejtë vote

Mbledhjen e hapi Kryetarja e Këshillit Drejtues Dr.Sc. Ema Berisha e cila i falënderoj për prezencën anëtarët e Këshillit dhe propozoi per miratim këtë:

REND DITE

1. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e gjashtë;
2. Miratimi i plotësimit të rregullores mbi përcaktimin e tarifave në studime dhe shërbime në Akademinë Tempulli
3. Marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve të rinjë
4. Caktimi i tarifave të studimeve ne Akademinë Tempulli
5. Të tjera.

Rendi i ditës i propozuar u miratua unanimisht nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

I. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e gjashtë

Kryetarja Znj. Berisha hapi diskutimin lidhur me Ekstraktin nga mbledhja e gjashtë, të pranishmit nuk patën asnjë vërejtje apo sygjerim lidhur me Ekstraktin e mbledhës së kaluar të Këshillit prandaj Dr.Sc. Ema Berisha propozoi për votim. Ekstrakti u miratua unanimitisht nga anëtarët e Këshillit Drejtues.

II. Miratimi i plotësimit të rregullores mbi përcaktimin e tarifave në studime dhe shërbime në Akademinë Tempulli

Kryetarja e Këshillit Drejtues Zj. Berisha si dhe Sekretarja e Akademisë znj. Fatime Berisha, elaburuan shkurtimisht plotësimin e rregullores mbi përcaktimin e tarifave të studimeve dhe shërbimeve në Akademi. Tarifat e studimeve në nivelin bachelor dhe master dhe pagesat për shërbime kanë pësuar disa ndryshime të cilat vijnë si nevojë e kohës së rritjes së kostos së shpenzimeve. Zj. Berisha, falënderoj Sekretarën për elaburimin e rregullores dhe gjithashtu u dha mundësi anëtarëve të tjerë për diskutim. Pasi që nuk pati komente apo vërejtje nga anëtarët e KD -së Kryesuesja propozoi të hudhet në votim në kjo rregullore.

Plotësimit të rregullores mbi përcaktimin e tarifave në studime dhe shërbime në Akademinë Tempulli u miratua njëzëri nga Anëtarët e Këshillit të Drejtues.

III. Marrja e vendimit për shpalljen e konkursit për student të rinjë

Zj. Berisha, vazhdoi me pikën e tjetër të rendit të ditës për hapjen e konkursit për studentë të rinjë. Duke pasru parasysh se jemi në afër datës së shpalljes së konkursit për studentë të rinjë atëhere po e hapi diskutimin për pranimin e studentëve të rinjë. Drejtori i Akademisë, z. Muhamet Krasniqi mori fjalë dhe theksoi se edhe këtë vit si cdo vit tjetër duhet të hapim konkurs për pranim të studentëve të rinjë në nivelin bachelor dhe master. Numrat e vendeve për student të jenë sipas numrave të përcaktuara nga aktredimi i prograve nga Agjensioni i Kosovës për Akredim (AKA). Anëtarët tjerë nuk patën diskutime dhe në mënyrë unanime u miratua për shpalljen e konkursit për student të rinjë në Akademi për vitin akademik 2022-23.

IV. Caktimi i tarifave për studime në Akademin Tempulli

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryetarja e Këshillit Drejtues hap diskutimin, lidhur me propozimet e tarifave për studime në Akademi. Znj. Krasniqi propozoj që për studime bachelor (BA) të vendoset cmimi 1386 euro për vit akademik, për studime bachelor (BSC) të vendoset



çmimi 1512 euro për vit akademik ndërsa për studime master (MSC) të jetë 1800. Të gjitha këto çmime janë në pajtim me Rregulloren mbi përcaktimin e tarifave në studime dhe shërbime në Akademinë Tempulli. Anëtarët e akademisë u pajtuan prandaj propozuan për votim. Kryetarja e hodhi në votim vendimin dhe u votua unanimisht nga të gjithë anëtarët.

Mbledhja përfundoi në ora 11:15.

Të tjera nuk pati në këtë takim.

Kryetarja e Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Ema Berisha Krasniqi

Procesmbajtësi:
Zj. Makfire Preniqi